



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.127/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Qerim Ademaj kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të Miratimit të Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.3/2025, të datës 30.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 08.12.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.3/2025, i datës 30.11.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.3/2025, të datës 30.11.2025, ka vendosur: I. Pranohet e bazuar ankesa ZP.A.nr.3/2025, e datës 27.11.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ndryshohet vendimi Nr.01/3438-2025, i datës 26.11.2025, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sa i përket Qendrave të Votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve si dhe listën e qendrave të votimit, ashtu që si Qendra të Votimit jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 dhjetor 2025, caktohen përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre. II. Lista e Qendrave të Votimit, si në pikën I të këtij vendimi përbëhet



vetëm nga Qendrat e Votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ashtu që të anulohet vendimi ZP.Anr.3/2025, i datës 30.11.2025, i PZAP-së, dhe të mbetet në fuqi vendimi i KQZ-së i datës 26.11.2025.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.3/2025, i datës 30.11.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 27.11.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2025 përveç tjerash ka diskutuar edhe rreth organizimit të procesit të votimit jashtë vendit. Në këtë mbledhje, pavarësisht kontestimit të bazuar të ligjshmërisë që i është bërë propozimit për të krijuar Qendra Alternative të Votimit jashtë hapësirave zyrtare të misionëve tona diplomatike, (Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 01/3438 - 2025, i datës 26.11.2025) është marrë me shumicë votash në këtë institucion duke provuar kështu të imponojnë një formë të re të organizimit të zgjedhjeve, me gjasë, më e përshtatshme për subjektin sponzorues të kësaj ideje, duke theksuar më saktësisht si në ankesën e paraqitur në PZAP.

KQZ më datë 29.11.2025, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka dhënë sqarime lidhur me procedurën e ndjekur, arsyet dhe rrjedhën se si ka ardhur deri te votimi në KQZ, duke theksuar më saktësisht si në përgjigje në ankesë.

Pas pranimi të përgjigjes në ankesë nga ana e KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.3/2025, të datës 30.11.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës se, me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, vendimi Nr. 01/3438-2025, i datës 26.11.2025 për Miratimin e Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maksimal të Votuesve, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni



96 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 2 paragrafi 2.2 i Rregullores Zgjedhore Nr.05/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit.

Paneli vlerësoi se procesin e votimit jashtë Kosovës përveç dispozitave të lartpërmendura e rregullon Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 96 edhe paragrafët: 6, KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike. 7. KQZ, përmes aktit nënligjor, rregullon mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, mënyrën e votimit, mbikëqyrjes, vëzhgimit, shpërndarjes, paketimit dhe dërgimit të materialit të votimit dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me votimin për shtetasit jashtë vendit. 8. KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve. Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t'i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ. PZAP vlerëson se pretendimet e KQZ të shprehura përmes përgjigjes në ankesë se qëndrimi i shumicës në këtë fazë ka qenë i nevojshëm që të mos shkaktohet dëm në proces të regjistrimit të votuesve jashtë vendit, gjegjësisht të mos shkaktohen vonesa, janë pretendime të paqëndrueshme për faktin se me dispozitën ligjore të nenit 96.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (Nr.08/L-228) në mënyrë shprehimore dhe të qartë është paraparë se Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: 31.1. fizikisht në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre....". Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.05.2024 për themelimin e dhe Menaxhimin e Qendrave të Votimit, përkatësisht në nenin 2 parashihet se "Qendrat e Votimit themelohen në 2.2. në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare", andaj sipas panelit me dispozita ligjore askund nuk është e paraparë e drejta e krijimit të qendrave të votimit jashtë hapësirave të përfaqësive diplomatike, andaj nga kjo rezulton se themelimi i qendrave të votimit për votim jashtë Kosove jashtë hapësirave të misionëve diplomatike, nuk mund të konsiderohen si qendra të vlefshme të votimit, krejt kjo me qëllim të garantimit të integritetit zgjedhor, pasi që krijimi i qendrave të votimit jashtë përfaqësive diplomatike mund të cenojë integritetin zgjedhor.

Tutje PZAP vlerëson se lejimi i qendrave të votimit vetëm brenda hapësirave të përfaqësive diplomatike është paraparë si masë mbrojtëse për të siguruar integritetin e votës dhe kjo assesi nuk mund të parashihet si pengesë në ushtrimin efektiv të te drejtave të votimit të shtetasve të Republikës së Kosovës që banojnë jashtë territorit të Kosovës. Paneli vlerëson se Republika e



Kosovës iu ka garantuar të drejtën e votës edhe shtetasve që jetojnë jashtë vendit, mirëpo e njëjta gjëthashtu ka përcaktuar edhe kushte ligjore për ushtrimin e të drejtës në fjalë.

Ka shtuar se sipas Panelit duke qenë se caktimi i vendvotimeve jashtë Kosovës është i përcaktuar me ligj, qëllimi i ligjvënësit është që të përcaktohen saktë vendvotimet jashtë Kosovës pra duke i kufizuar vetëm në Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Kosovës, e që sipas Panelit është një qëllim legjitim që është synuar të arrihet me këtë kufizim për të garantuar integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës, e i cili kufizim nuk do të ndikon në shprehjen e lirë të vullnetit të popullit përkritazi me përfaqësuesit e tyre në Kuvend duke qenë se me këtë përcaktim të vendvotimeve jashtë Kosovës nuk u pamundësohet votimi, pasi që votuesit jashtë Kosovës kanë të drejtë dhe mund të votojnë në fizikisht, në Përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së në postën e Kosovës dhe duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerëson se ligjvënësi nuk lejon fare alternativë për Qendrat e votimit jashtë Kosovës duke i përcaktuar si Qendra të votimit të vetme Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësirat e tyre, kjo edhe për faktin se sipas Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës rregullohet edhe organizimi i zgjedhjeve në nenin 96 të këtij ligji. Pra në tërësi procesi i votimit jashtë Kosovës është i përcaktuar që të organizohet dhe mbahet në Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Kosovës, jo edhe në vendet tjera jashtë Përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, lidhur me pretendimet për lejimin Qendrave të Votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve si dhe listën e qendrave të votimit. Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkritazi me shkeljet e pretenduara procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe veçanërisht vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 96 paragrafi 3 pika 3.1, nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “3. Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: 3.1. fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas



kritereve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale. 6. KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike. 7. KQZ, përmes aktit nënligjor, rregullon mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, mënyrën e votimit, mbikëqyrjes, vëzhgimit, shpërndarjes, paketimit dhe dërgimit të materialit të votimit dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me votimin për shtetasit jashtë vendit. 8. KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve. Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t'i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kritereve të përcaktuara nga KQZ”.

Me nenin 2 paragrafi 2 pika 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.05.2024 për Themelimin dhe Menaxhimin e Qendrave të Votimit, parashihet se: “Qendrat e Votimit themelohen në 2.2 .në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare”.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozitat e lartcekura, erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm.

Në raport me pretendimet ankimore të ankuesit se PZAP, gabimisht ka vlerësuar faktin se ankesa e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës është e bazuar, duke e anuluar vendimin e KQZ-së, sepse Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk e definon se çfarë parasheh “hapësira” e një ambasade apo konsullate dhe se PZAP, nuk mund të konkludoj as të konstatoj se çka nënkuptojmë me hapësirat e ofruara si vende ku mund të organizohet votimi, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, duke u mbështetur në nenin 96 paragrafi 8 të LZP-së, Gjykata Supreme e Kosovës këto pretendime i refuzoi si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se edhe përkundër faktit se sipas nenit 96 paragrafi 8 është përcaktuar se KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike, kjo nuk nënkupton se çdo propozim që vjen nga Ministria e Punëve të Jashtme, është e obligueshme për KQZ-në. Rekomandimi i dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme, duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LZP-së dhe të Rregullores Zgjedhore Nr.05.2024 për Themelimin dhe Menaxhimin e Qendrave të Votimit, në mënyrë që e njëjta të merret parasysh nga ana e KQZ -së, çdo sugjerim që bie ndesh me dispozitat ligjore dhe me rregulloren zgjedhore, nuk mund të jetë i obligueshëm. Kjo gjykatë vlerëson se ligjvënësi në formulimin e dispozitës ligjore ka përcaktuar qartë se votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për



mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit, pra kjo dispozitë nënkupton vetëm hapësirat që gjenden brenda objektit të përfaqësive diplomatike dhe në asnjë mënyrë jashtë tyre dhe kjo është përcaktuar në këtë mënyrë që të ruhet integriteti zgjedhorë në tërësi dhe vota e votuesit në veçanti. Ligji nuk parasheh mundësin e votimit edhe në objektet potencialisht të kontraktuara nga ana e përfaqësive diplomatike, qofshin ato për nevoja të ambasadës, apo konsullatës. Ligji parasheh hapësirat ku janë të vendosura përfaqësitë diplomatike që nënkupton vetëm hapësirat brenda atij objekti dhe në asnjë rrethanë vendet e tjera qofshin ato të kontraktuara nga përfaqësitë diplomatike apo jo dhe çdo vendim nga ana e KQZ në kundërshtim me këto kritere minon integritetin zgjedhor dhe cenon votën e votuesve.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se KQZ-ja nuk ka kompetencë që të krijojë qendra votimi jashtë përfaqësive diplomatike për faktin se ky veprim bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nr. 08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.05.2024 për Themelimin dhe Menaxhimin e Qendrave të Votimit dhe në parimet e administrimit zgjedhor.

Nuk qëndron as pretendimi i ankuesit në ankesë se vendimi i PZAP-së, është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se duhet të kemi parasysh se e drejta për të votuar, sipas nenit 45 të Kushtetutës, nuk përfshin detyrimin për shtetin që të organizojë forma specifike të votimit jashtë përfaqësive diplomatike, sepse mënyrat e ushtrimit të kësaj të drejte përcaktohen me ligj, në përputhje me mundësitë teknike dhe garancitë e sigurisë zgjedhore. Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk parashikon hapjen e qendrave të votimit jashtë ambienteve të përfaqësive diplomatike dhe çdo veprim jashtë këtij kuadri do të ishte tejkalim i kompetencave ligjore për organet zgjedhore. Për më tepër, votimi jashtë përfaqësive diplomatike krijon pasiguri juridike sa i përket juridiksionit, kontrollit, mbikëqyrjes dhe vlefshmërisë së procesit, pasi vetëm territori i përfaqësive diplomatike gëzon status të qartë ligjor që ofron garanci se do të mbrohet integriteti i zgjedhjeve.

Në raport me pretendimet e ankuesit se në bazë të nenit 139 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KQZ-ja, është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre dhe jo PZAP, Gjykata Supreme e Kosovës edhe këtë pretendim e refuzon si të pa bazuar për arsye se:

Me neni 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcaktohet se: “1. PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.

Me nenin 118 paragrafi 1 dhe 5 përcaktohet se: “1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht. 5. 5. Vendimi i PZAP-së është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveç nëse Gjykata Supreme të Kosovës vendos ndryshe”.



Me nenin 13 paragrafi 1 dhe 11 të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, përcaktohet se: “1. PZAP-i, vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme 11. Paneli me vendimin e tij mund të urdhëron KQZ-në, që të rishqyrtojë vendimin e vet dhe të marrë masa përmirësuese, apo që Paneli të ndryshon vendimin e KQZ-së dhe të vendos vet për çështjen e objektit lëndor.

Andaj nga dispozitat ligjore të lartcekura shihet qartë se PZAP, kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së, të paraqitura përmes ankesës në PZAP dhe ka kompetencë ekskluzive sipas vlerësimit të saj, e në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të bëjë ndryshimin e vendimit të nxjerr nga ana e KQZ-së. Andaj sipas këtyre dispozitave ligjore PZAP në asnjë rrethanë nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 139 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse PZAP, ka vendosur sipas ankesës së Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe atë lidhur me ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, dhe nuk ka nxjerr vendim sipas detyrës zyrtare që do të përbënte tejkalim i kompetencave ligjore ashtu siç pretendon ankuesi në ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kësaj ankese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas ankesës të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË


AA.nr.127/2025 datë 08.12.2025.

Kryetar i kolegjit,
Qerim Ademaj



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Runëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

